



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE E SHKENCËS
AGJENCIA QENDRORE E VLERËSIMIT TË ARRITJEVE TË NXËNËSVE

PROVIMI I MATURËS SHTETËRORE 2009

SESIONI I

(I DETYRUAR)

SKEMA E VLERËSIMIT TË TESTIT

VARIANTI A

Lënda: Letërsi dhe Gjuhë shqipe
Shkolla e mesme e gjuhëve të huaja

Udhëzime të përgjithshme:

- Testi përbëhet nga dy pjesë.
- Testi përmban një total prej 50 pikësh.
- Testi ka 25 pyetje. 13 me zgjedhje dhe 12 me zhvillim.
- Për pyetjet me zgjedhje përgjigja e saktë vlerësohet me 1 pikë.
- Për pyetjet me zhvillim përgjigjet konsiderohen orientuese dhe në skemë parashikohen variantet e mundësive të përgjigjeve të nxënësve. Për rastet kur përgjigja e nxënësit nuk përshatet plotësisht me përgjigjen në skemë, por afron me logjikën e pyetjes, komisioni i vlerësimit është i detyruar të këshillohet me drejtuesin teknik dhe me specialistët e AVA, për të bërë vlerësimin përfundimtar.
- Vlerësimi i pyetjes *ese* është specifikuar me kujdes. Vlerësimi i saj do të bëhet duke pasur parasysh rubrikat në tabelën e vendosur në fund të pyetjes dhe që është posaçërisht për vlerësuesit e testit.
- Saktësia gjuhësore ndikon negativisht në vlerësimin e nxënësit, në ato raste, kur ka përsëritje të theksuar gabimesh ose gabime të cilat prishin në mënyrë të vazhdueshme kuptimin e shprehjes.

PJESA I**Mitrush Kuteli****“Vjeshta e Xheladin Beut”**

Pyetja 1	D	1 pikë
Pyetja 2	B	1 pikë
Pyetja 3	B	1 pikë
Pyetja 4	D	1 pikë
Pyetja 5	C	1 pikë
Pyetja 6	B	1 pikë
Pyetja 7	A	1 pikë

Pyetja 8 **2 pikë****Model përgjigjeje**

Titulli nënkupton vjeshtën moshore të beut. Fragmenti përqendrohet kryesisht në pamjen e plakur dhe të rënë të beut: *te thinjat, mustaqet me fije argjendi, kokën tullupane, burrë me lapra dhe brazda*. Pra beu është në prag të dimrit që është sinonim i pragut të vdekjes.

Pikë të plota

2 pikë Nëse argumenton qartë dhe plotë lidhjen midis titullit dhe brendisë së fragmentit të dhënë në test. Përgjigjja duhet të mbështetet me detaje kuptimplota të cituara direkt nga teksti apo perifrazime.

Pikë të pjesshme

1 pikë Nëse argumenton pjesërisht lidhjen midis titullit dhe brendisë së fragmentit.

- Titulli nënkupton plakjen e beut.
- Titulli lidhet me fundin e beut.
- Vjeshtë në natyrë dhe vjeshtë te beu.

Përgjigjja nuk përmend në mënyrë të drejtpërdrejtë asnjë detaj nga fragmenti.

0 pikë Nëse përgjigjja e dhënë nuk i përmbahet thelbit të pyetjes ose nuk ka përgjigje.

Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë, shpreh mendime që nuk i përmban modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit i gjykon të sakta.

Pyetja 9 **4 pikë****Model përgjigjeje**

- a) Pasqyra i zbulon beut të vërtetën se ai po plakët dhe kjo është e pashmangshme.
 b) Gjendja shpirtërore: beu në fillim nuk e beson, por shumë shpejt tronditet, kalon momente krize, i merren mendtë, shokohet.

Detajet: nuk e njohu veten, mos e kish fajin pasqyra?, i vozitën mornica të ftohta nëpër trup, mendja zuri t'i qerthullohej, ment ra poshtë, ndenji në cep të divanit.

Pikë të plota

1 pikë Nëse gjen të vërtetën që pasqyra i zbulon beut.

DHE

1 pikë Nëse tregon gjendjen shpirtërore që i shkaktohet beut.

2 pikë Nëse gjen dy nga detajet e renditura më lart.

Pikë të pjesshme

1 pikë Nëse gjen të vërtetën që pasqyra i zbulon beut.

OSE

1 pikë Nëse gjen dy nga detajet e renditura më lart.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 10 **3 pikë****Model përgjigjeje**

- a) Ironinë e shkaktojnë: frazeologji dhe shprehje popullore, emra, mbiemra me ngjyrimë të forta emocionale.

Shprehje popullore (leksiku): me ballin brazda-brazda, si ca qime përçi plak, burrë me lapra, ndaheshin më dysh shtëllunga, koka tullupane.

Emra: lapra, breza, shtëllunga, përçi, misëroku.

Mbiemra: të kërcyer, të shfryrë, të varur, të kreshpëruara, të skuqur, tullupane, të zverdhura.

- b) Ndjesia: Pështirosje, neveri, etj.

2 pikë Nëse gjen dy mjete gjuhësore që krijojnë ironinë bashkë me ilustrimet përkatëse.

DHE

1 pikë Nëse shkruan ndjesinë që i shkakton kjo mënyrë portretizimi.

OSE

1 pikë Nëse gjen një mjet gjuhësor që krijon ironinë bashkë me ilustrimet përkatëse.

OSE

1 pikë Nëse gjen mjetet gjuhësore, por pa ilustrimet përkatëse.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 11 **3 pikë****Model përgjigjeje**

a) Xheladin beun e shqetëson e ardhmja, pasi e ndien plakjen e pashmangshme dhe plakja për të është pamundësi fizike për të zotëruar.

- E shkuara për të ka qenë e mbushur me një jetë të shthurur, që ai e ka shijuar deri në ekstrem, ndaj s'ka asnjë keqardhje për të. Atë e shqetëson e ardhmja, pasi e ndien pasigurinë e vet, veçanërisht në raport me gratë dhe pasurinë.
- Beu e di se plakja është vdekje, që do të thotë harrim, humbje, zhdukje. Ai s'ka trashëgimtarë dhe s'do të ketë mundësi më të shkojë me vajza të reja, të shijojë të mirat e kësaj jete.

b) Autori ofron dy imazhet për të theksuar se ç'do të humbasë beu.

- Imazhi i bukur që ofrohet hyn në kontrast të thellë me pleqërinë e pashmangshme të beut. Pikërisht ky është momenti kur ai bëhet i vetëdijshëm se po plaket realisht dhe pas kësaj vjen vdekja. Kjo për beun është tragjike.

Pikë të plota

1 pikë Nëse shpjegon pse beun e shqetëson e ardhmja.

DHE

2 pikë Nëse shpjegon rolin që luan imazhi i vajzave dhe natyrës pikërisht në këtë moment. Përgjigjja duhet të theksojë: kontrastin dhe tragjizmin.

Pikë të pjesshme

1 pikë Nëse shpjegon pse beun e shqetëson e ardhmja.

OSE

1 pikë Nëse shpjegon pjesërisht rolin që luan imazhi i vajzave dhe natyrës pikërisht në këtë moment. Përgjigjja thekson vetëm një anë: **kontrastin** ose **tragjizmin**.

- Për të treguar ç'po humbet.
- Për të theksuar se kompleksi më i madh i tij kanë qenë gratë dhe të ngrënët (nënkuptohet të mirat e natyrës)
- Për të treguar se s'do të mund t'i ketë kurrë.
- Për të treguar se pas kësaj do të vijë vdekja.
- Thekson çastin kur ai kupton se plakja është e pashmangshme.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë, shpreh mendime që nuk i përmban modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit i gjykon të sakta.

Pyetja 12 **2 pikë****Model përgjigjeje**

Mbyllja përmban një fjali pyetëse dhe një pohore të shoqëruar me reticencë. ku e fundit ka dhe një reticencë. Përgjigjja e nënkuptuar është se varri është harrimi përgjithmonë.

- E di se ç' të pret pas pleqërie? Është vdekja, harrimi, zhdukja.

2 pikë Nëse interpreton në mënyrë të plotë mbylljen e fragmentit duke u përqendruar në dy pyetjet, reticencën dhe ç' nënkupton heshtja.

OSE

1 pikë Nëse interpreton në mënyrë të pjesshme mbylljen e fragmentit duke u përqendruar se ç' nënkupton heshtja ose vetëm te dy fjalitë pyetëse.

- Pas vdekjes vjen harrimi.
- Beu e di se ajo që e pret është vdekja.
- Pyetja nënkupton se beu e ndjen se do t' i vijë vdekja.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë, shpreh mendime që nuk i përmban modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit i gjykon të sakta.

PJESA II**ESKILI****“Koeforet”**

Pyetja 13 **A** **1 pikë**

Pyetja 14 **D** **1 pikë**

Pyetja 15 **C** **1 pikë**

Pyetja 16 **C** **1 pikë**

Pyetja 17 **A** **1 pikë**

Pyetja 18 **A** **1 pikë**

Pyetja 19 **4 pikë****Model përgjigjeje**

Gjendja shpirtërore e Orestit kalon në dy faza: i lëkundur në pjesën e parë dhe i vendosur në të dytën. Arsyet janë:

- E ka të vështirë të vrasë nënën. Ç' të bëj, Pilad? Ku shprehet lëkundja për veprën që do të kryejë (ilustrimi).
- I duhet të marrë gjakun e babait. Më ndiq – i thotë me vendosmëri Klitemnestrës (ilustrimi).

Pikë të plota

2 pikë Nëse gjen dy arsytet e gjendjes së dyzuar të Orestit.

DHE

2 pikë Nëse gjen dy ilustrime për secilin rast.

Pikë të pjesshme

1 pikë Nëse gjen një arsye të gjendjes së dyzuar të Orestit.

- Nuk vritet nëna. OSE
- Duhet t'i marrë gjakun babait.

1 pikë Nëse gjen një ilustrim për gjendjen e dhënë në përgjigjen më sipër.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim (nuk ka kuptuar thelbin e veprës) ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 20 **2 pikë**

1 pikë Nëse gjen motivin e gjakmarrjes ose krimi sjell krimin.

1 pikë Ilustrimi: Po gjakut të babait, që më thërret, ç't'i bëj? (gjakmarrja)
Nuk të vras unë, ti veten vetë ke vrarë. (krimi sjell krimin)

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 21 **2 pikë****Model përgjigjeje**

a) Klitemnestra duke zbuluar gjirin dhe duke i treguar Orestit se është ajo që i ka dhënë qumësht, përpiqet të krijojë kështu imazhin e një nëne të dhembshur, të përkujdesur, të dashur.

b) Ajo përdor këto argumente:

- Vrasja që ajo kreu kundër të shoqit ishte shkruar nga perënditë: *Kështu nga Fati që e shkruar, bir.*
- I shoqi kishte faj (duke nënkuptuar flijimin që Agamemnoni i bëri së bijës).

1 pikë Nëse tregon imazhin që Klitemnestra përpiqet të krijojë te i biri.

DHE

1 pikë Nëse gjen një argument që përdor ajo për të justifikuar veten.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 22 **2 pikë****Model përgjigjeje**

E veçanta është përmbysja e rendit të fjalëve: inversioni. Mbiemri ka dalë në krye të fjalisë, përpara emrit. Arsyeja është theksimi, përqendrimi i emocionit të mbiemri e kobshmja, i cili parathotë veprën që do të ndodhë.

1 pikë Nëse gjen të veçantën e vargut

DHE

1 pikë Nëse shpjegon arsyen e këtij përdorimi.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 23 **2 pikë****Model përgjigjeje**

Njerëzit janë të pafuqishëm ndaj fatit. Janë perënditë ato që vendosin për ta dhe nëse nuk u binden atëherë do të ndëshkohen (deri në breza, si familja e atridëve).

2 pikë Nëse shpjegon në mënyrë të plotë mendësinë e lashtë greke në lidhje me fatin.

OSE

1 pikë Nëse shpjegon pjesërisht mendësinë e lashtë greke në lidhje me fatin.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 24 **3 pikë**

2 pikë Grua e urryer, e cila është gati të bëj gjithçka për të shpëtuar. Ajo shfaqet vrasëse, nënë jo e denjë për fëmijët (e ka shitur Orestin) dhe jo besnike ndaj martesës.

OSE 1 pikë Nëse thotë vetëm një cilësi që ajo ka.

1 pikë Theksohen për të motivuar veprimin që Orestin do të kryejë, pra vrasjen e së ëmës.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 25 **8 pikë**

Për esenë do të ndiqen kriteret e mëposhtme:

KRITERI I: SHTJELLIMI I IDESË**2 pikë**

Vlerësuesi do të shikojë nëse nxënësi:

- shkruan një ese ku argumenton pse Oresti është figura më tragjike e kësaj tragjedie;
- përqendrohet në idenë madhore që përcjell autori përmes saj në tragjedi (Krimi sjell krimin).
- i mbështet idetë e veta me shembuj nga poezia.
- përdor detaje mbështetëse.
- ka qartësi mendimi.

KRITERI II: ORGANIZIMI DHE STRUKTURA E ESESË**2 pikë****1 pikë** **Struktura e esesë**

- respekton elementet e strukturës së esesë:
hyrjen
zhvillimin
përfundimin

Nxënësi merr **1 pikë** nëse përgjigjen e dhënë e strukturon sipas skemës së mësipërme.

Nëse mungon njëra prej tyre, ai do të marrë 0 pikë për këtë rubrikë.

1 pikë **Organizimi i esesë**

- organizim logjik, ku shfrytëzohen teknika të tilla si koherenca dhe unifikimi i paragrafëve (lidhja logjike mes paragrafëve, kalimi në mënyrë të natyrshme).

KRITERI III: STILI DHE ORIGJINALITETI**2 pikë**

Vlerësuesi do të shikojë nëse nxënësi:

- përmes gjuhës që përdor, krijon një përshtypje të përgjithshme për atë që do të shprehë.
- shprehët me një gjuhë eseistike.
- ka fjalor të pasur.
- stil origjinal.

KRITERI IV: SAKTËSIA GJUHËSORE**2 pikë****(1 pikë sintaksa dhe 1 pikë drejtshkrimi)**

Vlerësuesi do të shikojë nëse nxënësi:

- strukturon qartë përgjigjen nga pikëpamja gramatikore.
- ndërton fjali që janë të sakta dhe të qarta.
- përdor fjali që variojnë në modele, gjatësi dhe ritëm.
- ka saktësi drejtshkrimore.